



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

VENDIM

Nr.18, datë 05.12.2024

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIM TË LEJES, NGA
BASHKIMI I PËRKOHSHËM I SHOQËRIVE “EURON”, “KADRIA”
DHE “TEUTA KONSTRUKSION” TEK SHOQËRIA
“ALB-ENERGY” SH.P.K.**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për transferimin e lejes miratuar me vendim nr.1, datë 18.02.2009, “Leje për përdorim rezerve ujore për prodhim energjie, HEC TOPOJAN 1 dhe BELE 2.

Nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Euron”, “Kadria” Dhe “Teuta Konstruksion” tek shoqëria “Alb-Energy” sh.p.k me Nipt L51503039D.

2. Ngarkohet Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit

KRYETARI I KBU DRIN-BUNË

MAJLINDA ANGONI

